

I Nderuar z. Kryetar i Komisionit,

Të nderuar anëtarë të Komisionit

1. Fillimisht ju falenderojmë për ftesën që na keni bërë për të dhënë sugjerimet dhe mendimet tona lidhur me reformën territoriale administrative si një organ Kushtetues ku në qëndër të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë.
2. Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur zhvillimet e fundit që janë zhvilluar për reformën territoriale – administrative. Dhe në këtë kuadër **jemi të mendimit se kjo reformë është e nevojshme dhe duhet bërë pasi është një domosdoshmëri që e kërkon vetë koha në kuadër të gjithë problemeve që janë identifikuar.** Duke ju referuar dhe Progres raporteve të Komisionit European të tre viteve të fundit, shqetësimi i tyre është mungesa e përparimit në reformën administrative territoriale kjo për shkak dhe të zbatimit të ngadaltë të Ligjit për planifikimin territorial dhe pamundësisë financiare të njësisve të vogla. *(referuar progres raportit të Komisionit European 2013).*
3. Në këto 14 vjet që nga krijimi i Institucionit të Avokatit të Popullit na janë drejtuar me mijëra ankesa nga shtetasit si përkundrejt bashkive dhe komunave. Shumë ankesa që duheshin zgjidhur në komuna dhe bashki nuk janë zgjidhur jo vetëm për arsye subjektive, por sidomos për shkak të administratës lokale ineficente, të dobët ekonomikisht dhe financiarisht, me mungesë investimesh dhe me një organizim burokratik, me mungesë kompetencash, etj. Gjithashtu lëvizja e pakontrolluar e njerëzve ka sjellë probleme të abandonimit të territoreve të gjera, të mungesave të ndjeshme në infrastrukture dhe shërbime; në humbjen e kontrollit të territorit dhe të pasurisë së madhe kombëtare, tokës bujqësore; në mospagimin e taksave vendore, në uljen e dukshme të cilësisë në fusha të tilla si arsimimi dhe shëndetësia e tjera.

Sigurisht, decentralizimi është një komponent i rëndësishëm në procesin e transformimit social, pasi sjell qytetarët më afër me pushtetin, duke rritur aksesin në qeverisje, si dhe krijon premisa për një qeverisje më efektive. **Në këto kushte, reforma adminitrativo-**

territoriale është një proces i rëndësishëm, por i cili jo vetëm që nuk mund të përfundohet në një kohë të shkurtër por gjithashtu kërkon miratimin e një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore për ta bërë të zbatueshëm.

4. Duke u nisur nga objekti i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, që ndër të tjerash është monitorimi i administratës publike në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të shtetasve të cënuar nga veprimet/mosveprimet e institucioneve shtetërore, **sugjerojmë që në përgatitjen e kësaj reforme të mbahet parasysh në rradhë të parë interesin madhor ndaj qytetarit dhe të drejtave të patjetërësueshme të tyre.**
5. Në funksion të mirëadministrimit të pushtetit, nevojitet reformë e vazhdueshme decentralizuese, si rruga e vetme që përmirëson cilësitë qeverisëse vendore, në drejtim të rritjes së efektivitetit, efijencës, përgjegjshmerisë, si dhe rritjes së transparencës përgjatë ushtrimit të kompetencave, jo vetëm nga palët pjesë e procedimeve administrative, por dhe nga komuniteti i gjerë.

Nisur nga objekti i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit por edhe të organizatave jofitimprurëse rendësi ka sensibilizimi i shtetasve lidhur me këtë reformë. Kjo duke e parë dhe si një detyrim kushtetues në kuadër të nenit 108 të Kushtetutës ku thuhet se për ndarjet administrative – territorial të njësisve të qeverisjes vendore vec interesave të përbashkëta ekonomike dhe tradita historike ...**“kufijtë mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to”**... Kjo kërkesë kushtetuese është në përputhje edhe me Kartën Europiane të Autonomisë Lokale. **Ne si institucion i Avokatit të Popullit do të sugjeronim që për përmbushjen e kësaj detyre kushtetuese të hartohet një plan i detajuar dhe me afate zbatuese. Ky plan do të sugjeronim të ishte transparent si dhe sugjerojmë që të zhvillohen takime me grupe individësh që banojnë në qytete dhe në komuna duke i informuar qëllimin e kësaj reforme, në cilat drejtime ju shërben atyre dhe cili do të ishte varianti më i përshtatshëm për ndarjen territorial.**

6. Gjatë këtyre viteve veprimtari të Institucionit të Avokatit të Popullit është vënë re një sorrollatje e shtetasve dhe një burokraci e madhe nga pushteti vendor për zgjidhjen e

problemeve të ndryshme. Kjo për shkak se në të shumtën e rasteve njësitë e vogla të pushtetit vendor janë shpesh ekonomikisht të paqëndrueshme (*shqetësim i shprehur dhe nga Komisioni European në Progres raportin e vitit 2012*).

7. Ajo çfarë ne kemi evidentuar nga veprimtaria jonë gjatë këtyre viteve nga ankesat e adresuara por gjithashtu dhe nga rastet e ndjekura me iniciativë, për organet e pushtetit vendor si bashkitë dhe komunat është që kanë një paqëndrueshmëri si financiare ashtu dhe mungesë të eficensës së punës së tyre dhe shërbimeve që ofrojnë tek qytetarët. Madje në të shumtën e rasteve sipas progress raportit të Komisionit European 2012 dhe 2013, vendimmarrjes së pushtetit vendor i mungon transparenca dhe konsultimet me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit. Ky është një problem që është konstatuar edhe gjatë shqyrtimit të ankesave nga ana jonë, ku shumë individë jo vetëm që nuk thirren në mbledhjet publike të organeve kolegjiale vendimmarrëse, por edhe nuk informohen mbi vendimet që ato kanë marrë tashmë. **Për këtë arsye do të sugjeronim që në hartimin e kësaj reforme të mbahet parasysh krijimi i kushteve për rritjen e rolit dhe aksesit të qytetarit në vendimmarrje të organeve të pushtetit vendor me qëllim përfaqësimin më të mirë të problematikës së rajoneve përkatëse.**
8. Janë vënë re pengesa të bashkëpunimit në nivel bashkiak si dhe pengesa të bashkëpunimit dhe moskoordinimit midis pushtetit vendor dhe qendror duke e bërë shpesh herë mungesë eficence të shërbimeve që ofrohen në interes të qytetarëve, duke riparë funksionin dhe kompetencat e Prefekturës dhe Këshillit përkatës. **Për këtë arsye do të sugjeronim që të ketë bashkëpunim dhe koordinim midis dy pushteteve ashtu si dhe me aktorë të tjerë të shoqatave të njëjësive të pushtetit vendor dhe aktorëve të shoqërisë civile.**
9. Ne si Institucion i Avokatit të Popullit bashkohemi me mendimin se zonat minoritare duhet që në maksimum të mbeten ashtu sic janë qoftë dhe si njësi me numrin minimal të caktuar por duke patur parasysh që të mos u mungojnë shërbimet e nevojshme dhe investimet përkatëse.

10. Në kuadër të objektit të punës tonë dhe nga problematikat e rezultuara gjatë trajtimit të ankesave lidhur me pushtetin vendor kemi konstatuar se për vitin 2013 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë rregjistruar gjithsej 589 ankesa ndaj Njësive të Qeverisjes Vendore nga të cilat 140 ankesa ndaj Komunave. Objekti i ankesave ka qënë kryesisht për veprime lidhur me të drejtën e punës (130 ankesa), për pagesat për aftësinë e kufizuar (172 dhe 63 ankesa), për të drejtën për strehim (86/6 ankesa), për ndihmën ekonomike (34/13 ankesa), për veprimet e INUV dhe INUK (38/5), për të drejtën e pronës (25 ankesa), për të drejtën për informim (12/1), mbrojtjen e konsumatorit (10/11 ankesa), etj. Ajo që vëmë re është se mungesën e efikasitetit të punës dhe shërbimeve të ofruara nga njësitet e pushtetit vendor e vëmë re dhe në moskthimin e përgjigjeve të shkresave drejtuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit kur adresojmë shqetësime ose kur kërkojmë shpjegime dhe informacioni sipas kompetencave që ligji jep. **Do të sugjeronim që problemet që ne kemi evidentuar dhe adresuar nga qytetarët të gjejnë zgjidhje në reformën e re territorial – administrative, me qëllim që problem të tilla të shmangen dhe të mospërsëriten, por tu jepet një zgjidhje përfundimtare.**

11. Duke marrë shkas nga problemet që evidentojmë më së shumti nga ankesat që na adresohen për pushtetin vendor sidomos ato për strehimin e popullsisë së shumicës por vecanërisht dhe të minoritetit rom, do të sugjeronim të mbaheshin parasysh në reformën territorial – administrative dhe rishikimin e politikave të strehimit me qëllim bërjen sa më efikase në interes të qytetarit. Pasi nga statistikat e institucionit tonë gjatë tre viteve të fundit rezulton se janë 527 ankesa vetëm për strehimin. Kur nga një informacion që ne kemi marrë nga 42 Bashki, na rezulton se nga numri total i personave me statusin e të pastrehit, vetëm 13% e tyre kanë qënë përfitues. Në një kohë që bashkitë dhe komunat shfaqësohen me faktin se kanë mungesë fondesh. **Për këtë do të sugjeronim që problematika të tilla të mbahen parasysh dhe të adresohen në mënyrë të drejtë dhe gjejnë vend dhe në ndarjen e re territorial administrative.**

12. Fragmentarizimi i njësive territoriale ka pasqyruar dhe mosfunksionimin real ose mosshtrimin efektiv të detyrave ligjore të këtyre njësive vendore. Nga veprimtaria jonë kemi konstatuar mosfunksionim efektiv të INUV Komuna, kjo si pasojë e

pamjaftueshmërisë së fondeve për të përballuar prishjen e objekteve pa leje Brenda territorit administrativ në juridiksionin e tyre, kjo si pasojë e faktit se 70% e tyre nuk realizojnë asnjë të ardhur. **Për rrjedhojë, mendojmë se një ndarje e re territoriale, duke konsoliduar njësitet administrative në një numër më të vogël se aktualisht, do të krijonte premisa për një praktikë punë më efektive sa i përket realizimit të detyrave funksionale lidhur me veprimtarinë në fushën e ndërtimit.**

13. Lidhur me kriteret e përcaktuara, në referim të së cilave do të kryhet reforma administrative-territoriale, problem paraqitet në ndarjen e atyre njësive ku përfshihen komunitetet minoritare. Sipas kriterëve për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore si kriter përjashtues do të shqyrtohen rastet që marrin në konsideratë praktikën më të mirë ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve etnike aty ku këto minoritete vendosin shumicën e popullsisë, sugjerojmë mosprekjen e kufijve territorial për këto grupe. **Dhe nësi Institucion i Avokatit të Popullit qëndrojmë me të njëjtën mendim dhe sugjerojmë se mosndryshimi i kufijve të këtyre njësive, duhet të përbëjë elementin kyç në përcaktimin e kriterit të veçantë përjashtues për këto zona territoriale, si dhe një konsultim më të gjërë me vetë aktorët e këtyre komuniteteve.**

14. Administrata e disa organeve të qeverisjes vendore ka probleme me formulimin e akteve administrative, mungesën e referencave ligjore, mënyrën e procedimit administrativ, mosrespektimin e afateve ligjore, shkeljen e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përfundimin e procedimit me marrjen e një vendimi, të drejtën për të informuar individët, konflikt të interesave në vendimmarrje, lidhjet gjinore apo farefisnore mes pushtetarëve lokal dhe banorëve, duke sjellë edhe subjektivizëm në vendimmarrje, si edhe në ekzekutim të akteve administrative apo planeve konkrete të njësive të qeverisjes vendore. **Të gjitha këto probleme sjellin një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve të banorëve, si dhe moshmangësi të standardeve të njëjta administrative në shërbim të individit. Sugjerojmë, të mbahen parasysh strukturat e qeverisjes vendore me qëllim që të rritet dhe performanca e organeve të qeverisjes vendore si dhe të rritet cilësia e shërbimit.**

15. Por nga ana tjetër, duhet të kemi parasysh se ndarja e re territoriale administrative do të sjellë uljen e numrit të njësive vendore dhe për pasojë do të sjellë dhe largimin nga puna të një sërë punonjës që punojnë në këto njësi. Nga disa të dhëna fiskaleçekonomike rezultojnë rreth 20.000 të punësuar në Qeverisjen Vendore, 6500 Këshilltarë dhe 2000 kryetarë fshattrash. **Për këtë arsye do të sugjerohet që të mbahet parasysh me qëllim rritjen e mundësive të punësimit duke e zbërthyer në një strategji ose në një plan masash.**

16. Gjithashtu sugjerojmë që të mbahet parasysh në reformën e re për të ngritur struktura të qeverisjes vendore sa me efikase nga pikpamja organizative si dhe nga pikëpamja infrastrukturës rrugore, me qëllim që kjo reform të passjell rritje të efikasitetit të dhënies së shërbimit dhe rritjes së aksesit të qytetarit në njësitë e pushtetit vendor.

Si përfundim, në mbështetje të realizimit të reformës territoriale administrative e konsiderojmë si një hap pozitiv që po ndërmerret por gjithmonë duke patur në qendër të gjithë këtij procesi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duke patur parasysh rritjen e efikasitetit të burimeve njerëzore dhe financiare por dhe rritjen e cilësisë së shërbimit dhe numrit të tyre.

KOMISIONERE

Etilda Gjonaj (Saliu)